

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.61/2012, “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.61/2012 ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, propozohet në kuadër të paketës fiskale 2019. Ky projektligj synon:

- ndryshimin e nivelit të akcizës për produktin e duhanit të grirë, purot, cigarillos dhe cigaret me zëvendësues duhani;
- shtimin e një produkti të ri “duhan me ngrohje”, në listën e mallrave të akcizës;
- heqjen nga lista e mallrave të akcizës fishekzjarrët, llambat, pilat/bateritë dhe rëra bituminoze;
- vendosjen e akcizës për produktin “zhavorr bituminoz”;
- saktësimin e metodës së përlllogaritjes së akcizës për produktin nikotin lëng për mbushjen e cigareve elektronike;
- ndryshime në Kreun e shkeljeve në fushën e akcizës dhe sanksionet.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimi i nivelit të akcizës për produktin e duhanit të grirë, purot, cigarillos dhe cigaret me zëvendësues duhani.

Ligji aktual nr.61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë ” të ndryshuar, ka parashikuar për kategorinë T400 “Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit”, nivelin e taksimit në masën 4400 lekë/kg. Me anë të këtij

projektligji, propozohet që për këtë kategori niveli i akcizës të rritet në masën 6000 lekë/kg.

- *Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit*

Si është:

T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit	24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	4400 lekë/kg
--	-------	--	--------------

Si propozohet:

T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit	24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	6000 lekë/kg
--	-------	--	--------------

Ky propozim vjen me argumentet, si më poshtë vijon:

- Me qëllim përafrimin/barazimin e taksimit të produkteve të kësaj kategorie me kategorinë T200 “Cigare që përmbajnë duhan”, propozohet që niveli i taksimit të bëhet 6000 lekë/kg, në të njëjtën masë të parashikuar në kalendarin e taksimit të cigareve (kategoria T200) më 1 janar 2019.
- Referuar të dhënave për shtetet Kosovë dhe Maqedoni, rezulton se për këto dy kategori (T200 dhe T400), niveli i taksimit për njësi konvencionale është i njëjtë.
- Me qëllim përafrimin e mëtejshëm me Direktivën e BE 2011/64, e cila përcakton nivelin minimal të akcizës për duhanin e grirë të paktën 60 euro për kg, riskedulimi i rritjes siguron një politikë të qëndrueshme taksimi sipas standardeve të BE-së.
- Përqindja e akcizës në çmimin me pakicë të duhanit të grirë në Shqipëri dhe vendet e rajonit, bazuar në të dhënat e vitit 2017.

Pesha e taksës së Akcizës në çmimin e duhanit të tymosshëm në Shqipëri dhe në vendet e rajonit

Taksa të markës më të shitur të duhanit të tymosshëm

Vendet	Çmimi i duhanit të tymosshëm në USD	Përqindja e totalit të taksave në çmimin e shitjes	Përqindja e Akcizës specifike	Përqindja e Akcizës Ad Valorem	Total (%) Akciza ndaj çmimit
Shqipëri	1.96	53.3%	36.7%		36.7%
Mal i Zi	1.39	56%	40%		40%
Maqedoni	1.08	62.5%	35.6%		35.6%

Serbi	1.66	64.7%		43%	43%
Bosnje Herzegovina	0.71	62%		42%	42%

Burimi: World Health Organisation

Vihet re se përqindja e totalit të taksave në çmimin përfundimtar të duhanit të tymosshëm zë një peshë më të vogël në krahasim me vendet e tjera të rajonit.

- Rritja e akcizës për cigaret është një nga politikat e përdorura për frenimin dhe uljen e konsumit të cigareve nga popullata si produkt me efekte negative në shëndet, duke rritur çmimin e shitjes së tyre. Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit parashikohet të jetë +140 milionë lekë.
- *Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani*
Niveli aktual i akcizës për kategorinë T500 “Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani”, është në masën 4400 lekë/kg. Propozohet rritje e nivelit të akcizës në masën 6000 lekë/kg.

Si është:

T300 Puro dhe cigarillos	24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	4400 lekë/kg
T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	4400 lekë/kg

Si propozohet:

T300 Puro dhe cigarillos	24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	6000 lekë/kg
T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	6000 lekë/kg

Ky propozim vjen me argumentet:

- Puro dhe cigarillos janë produkte me konsum të ulët dhe nga shtresa me të ardhura të larta, ndërkohë që aktualisht kanë nivel të njëjtë taksimi me duhanin e grirë, që konsumohet gjerësisht dhe nga shtresa me të ardhura më të ulta.
- Tregtimi i purove dhe cigarillos ka nevojë për korrektim dhe standardizim të produkteve të akcizës që përmbajnë duhan. Puro dhe cigarillos janë produkte luksi dhe për këtë qëllim rritja e nivelit të taksës vjen në të njëjtën linjë me qëllimin e taksës së akcizës.
- Me qëllim përafrimin/barazimin e taksimit të produkteve të kësaj kategorie me kategorinë T200 “Cigare që përmbajnë duhan”, propozohet që niveli i

taksimit të bëhet 6000 lekë/kg, në të njëjtën masë sa parashikuar në kalendarin e taksimit të cigareve (kategoria T200) më 1 janar 2019.

- Referuar të dhënave për shtetet Kosovë dhe Maqedoni, rezulton se për këto kategori (T200, T300 dhe T500), niveli i taksimit për njësi konvencionale është i njëjtë.

Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit parashikohet të jetë +3.8 milionë lekë.

Shtohet kategoria T402 “Duhan me ngrohje” në kreun 2403, kodi tarifar 2403 90 90 me akcizë 6000 lekë/kg.

Propozimi:

T402 Duhan me ngrohje	2403 90 90	Duham me ngrohje, produkte duhani të riformuar dhe me substanca të tjera, që konsumohen nga një proces ngrohje nëpërmjet një aparati elektronik për ngrohjen e duhanit.	6000 lekë/kg
--------------------------	------------	---	--------------

Arsyeja për shtesën e kësaj kategorie në listën e mallrave të akcizës është se në tregun vendas do të tregtohet një produkt i ri, “duhan me ngrohje”. Referuar njoftimit dhe kërkesës së kompanisë përkatëse, tregtues të këtij produkti, për krijimin e një formati të ri pulle akcize për produktin “Duhan me ngrohje”, në sistemin SICPATRACE. Në bazë të kërkesës paraprake të subjektit për ITD (Informacion Tarifar i Detyrueshëm), nga Drejtoria e Tarifës dhe Originës është lëshuar kjo ITD dhe është konkluduar se ky artikull klasifikohet në kodin 2403 90 90 të kreut 2403 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, në të cilin përfshihen:

Kategoria T402 – 2403 “Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit, duhan i “homogjenizuar” apo i “rindërtuar”, ekstrakte dhe esenca prej duhanit”.

Ky produkt paraqitet në formë cilindrike (sikurse cigarja), por konsumohet vetëm nëpërmjet një aparati, i cili është i prodhuar posaçërisht për të. Referuar ligjit nr.61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, shtojca nr.1, në kategorinë T400 përfshihet duhan që klasifikohet në kreun 2403 të NK dhe akciza është në masën 4400 lekë/kg (propozuar në masën 6000 lekë/kg në 1 janar 2019). Aplikimi i akcizës për këtë produkt, në vendet të cilat e tregtojnë, është i ndryshëm, por duke mbizotëruar taksimi në kg. Referuar përvojave të vendeve të Bashkimit Evropian, (përveç Italisë e cila e takson për 1000 fije) llogaritja e akcizës së këtij produkti bëhet duke u bazuar në taksimin për kg. Bashkimi Evropian, lidhur me klasifikimin dhe taksimin e këtij produkti për

vendet anëtare të BE-së, rekomandon që këto produkte (duhani me ngrohje) të trajtohen si duhan i përpunuar i grirë, duke e taksuar në njësinë matëse kg.

Përsa më sipër, propozojmë që taksimi për akcizën e këtij produkti si dhe llojeve të tjera të produkteve të ngjashme me të, të kategorizohen në një nënkategori të re, ku të përfshihen produkte të kreut 2403, Kategoria T402 specifikuar me kodin 2403 90 90 të NK, dhe niveli i akcizës të llogaritet 6000 lekë/kg.

Kategoria T401 në rubrikën shkalla e taksimit, detajohet nga “10 lekë/ml” në “10 lekë/ml të totalit të litrave brenda ambalazhit”.

Si është:

T401 Nikotinë lëng për mbushjen e cigareve elektronike, të përcaktuara në kode 85 43 70 90, të përdorura për krijimin e një procesi tymosjeje	38 24 99 56 38 24 99 57	Nikotinë lëng për mbushjen e cigareve elektronike, të përcaktuara në kode 85 43 70 90, të përdorura për krijimin e një procesi tymosjeje	10 lekë/ml
--	----------------------------	--	------------

Propozimi:

T401 Nikotinë lëng për mbushjen e cigareve elektronike, të përcaktuara në kode 85 43 70 90, të përdorura për krijimin e një procesi tymosjeje	38 24 99 56 38 24 99 57	Nikotinë lëng për mbushjen e cigareve elektronike, të përcaktuara në kode 85 43 70 90, të përdorura për krijimin e një procesi tymosjeje	10 lekë/ml të totalit të litrave brenda ambalazhit
--	----------------------------	--	--

Problematikat e hasura gjatë zbatimit të këtij niveli taksimi nga struktura të ndryshme zbatuese, mbikëqyrëse si dhe kontestime nga subjektet importuese janë lidhur me mënyrën e taksimit të këtij produkti, konkretisht me metodikën e përlllogaritjes së detyrimit të akcizës mbi totalin e litrave që përmban produkti i gatshëm (lëng+nikotinë lëng) dhe jo vetëm përqindjen e nikotinës lëng në produkt.

Përsa më sipër, lind nevoja për saktësim në rubrikën taksim të shtojcës nr.1 të ligjit nr.61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, duke shtuar “totalit të litrave brenda ambalazhit”. Referencat lidhur me metodologjinë e përdorur në përlllogaritjen e akcizës për produktin nikotinë lëng, janë marrë nga të dhënat e disponueshme nga Agjensia e Doganave Italiane.

Heqjen nga lista e mallrave të akcizës fishekzjarrët, llambat dhe pilat/bateritë në Kategoritë F000, A100 dhe Y100.

Duke nisur nga viti 2012, fishekzjarrët, llambat dhe pilat/bateritë janë trajtur si mall akcize, respektivisht në masën 200 lekë/kg dhe 100 lekë copa, pasqyruar si më poshtë.

V Fishekzjarrët			
F000	36 04 10 00	Fishekzjarrët	200 lekë/kg
Fishekzjarrët			
F000	36 04 90 00	Të tjera	200 lekë/kg
VII PILAT DHE BATERITË PRIMARE; AKUMULATORËT ELEKTRIKË			
A100	85 06	Pilat dhe bateritë primare	200 lekë/kg
Pilat dhe bateritë primare			
Y100 Llambat inkandeshente	85 39 22 10	Llambat reflektor	100 lekë/copa
	85 39 22 90	Të tjera	100 lekë/copa
	85 39 29 92	Më tepër se 100 V	100 lekë/copa
	85 39 29 98	Jo më tepër se 100 V	100 lekë/copa

Ky propozim vjen me argumentet, si më poshtë vijon:

- Nga pikëpamja doganore, importuesit paguajnë akcizën në momentin e importimit dhe nuk kanë më procedurë tjetër mbikëqyrjeje, pra nuk jepen autorizime për këto produkte;
- Menaxhimi i produkteve të tilla ëshë i vështirë sepse, për shkak të specifikave, ato janë lehtësisht të transportueshme dhe, për arsye të ngarkesës fiskale me akcizë, rritet interesi i operatorëve për kontrabandë;
- Heqja e këtyre produkteve nga lista e mallrave të akcizës do të ndihmojë në uljen e interesit të operatorëve për të kryer kontrabandë, me qëllimin që të deklarojnë sasinë reale. Në këtë mënyrë do të arkëtohen më shumë të ardhura në TVSH dhe taksë doganore.

Efekti në të ardhurat nga akciza parashikohet të jetë -40 milionë lekë, por ka një pritshmëri të rritjes së sasive të deklarimeve për këto produkte, duke sjellë kështu rritje të të ardhurave nga TVSH-ja dhe taksat doganore.

Heqjen nga lista e mallrave të akcizës, të produktit “rërë bituminoze” me kod 27 14 10 00 dhe vendosjen e akcizës në masën 1 lekë/kg, për produktin “zhavorr bituminoz” me kod 27 14 90 00.

Ky projektligj propozon heqjen nga lista e mallrave të akcizës, të produktit rërë bituminoze, i cili aktualisht akcizohet në masën 2 lekë/kg, me arsyet e mëposhtme:

- nuk mund të përdoret si lëndë djegëse zëvendësuese, pasi përmbajtja e bitumit është 6-9%;
- ka çmim 3 herë më të ulët se “zhavorri bituminoz”;
- përdoret vetëm për shtresat asfaltike të varfra.

Ndërkohë, propozojmë vendosjen e akcizës në masën 1 lekë/kg për produktin “Zhavorr bituminoz”, me kod 27 14 90 00, me argumentet, si më poshtë vijon:

- Përdorimi gjithnjë në rritje i lëndëve djegëse zëvendësuese në industrinë e prodhimit të tullave e të çimentos, që, sipas NKM-së klasifikohen në Kapitullin 27 “Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre, substancat bituminoze, dyllet minerale”, dhe pikërisht në kodin “27 14 90 00”, me përshkrim “zhavorr bituminoz”.
- Referuar interpretimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), këto produkte njihen teknikisht me emrin “*qymyr bituminoz (bituminous coal)*” dhe sipas AKBN-së, këto produkte kanë një përmbajtje squfuri që varion nga 5% - 6%, përmbajtje karboni nga 42% - 44%, si dhe lëshojnë në atmosferë hire djegës në nivelin 25% - 35%.
- Ligji nr.61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 1 dhe 3, të nenit 50, ka parashikuar:

1. Në kuptim të këtij ligji, konsiderohen produkte energjetike produktet e mëposhtme:

...

b) që klasifikohen në kodet NK 27 01 27 02 dhe 27 04 deri në 27 15;

3. “i nënshtrohen pagesës së akcizës, sipas të njëjtit nivel akcize” çdo produkt “që përdoret si zëvendësues, mbushës ose shtues për lëndët djegëse, ose karburantet”.

Produkti “zhavorr bituminoz” me kod NK 27 14 90 00, bën pjesë tek produktet e klasifikuara në pikën 1, të nenit 50, dhe si i tillë, ky produkt, duhet t’i nënshtrohet pagesës së akcizës në të njëjtin nivel me produktin që zëvendëson, kur përdoret si zëvendësues për lëndët djegëse. Aktualisht, mbi koksin e naftës, aplikohet akcizë në masën 2 lekë/kg dhe taksë karboni 3 lekë/kg, duke përfaqësuar një ngarkesë fiskale në masën 40% mbi çmimin e shitjes. Ndërkohë për zhavorin bituminoz propozohet të vendoset akciza në masën 1 lekë/kg, duke ruajtur në këtë mënyrë të njëjtën ngarkesë fiskale me produktin që zëvendëson.

Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit parashikohet të jetë +40 milionë lekë.

Gjithashtu, me anë të këtij projektligji propozohet të shtohet produkti “duhan i grirë”, në pikën 5, të nenit 41 “Aplikimi i pullave fiskale”, me qëllim për të disiplinuar qarkullimin e duhanit të grirë dhe për të respektuar përcaktimet e ligjit nr.8691, datë 16.11.2000, “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, neni 17, i të cilit përcakton:

“Produktet e duhanit, të prodhuesve të vendit ose të importit, të pranishme në tregun shqiptar, tregtohen vetëm me pullë fiskale, të ngjitur në ambalazhin përdorues, nën letrën e tejdukshme të paketës.”

Ndryshime në kreun e shkeljeve në fushën e akcizës dhe sanksionet.

Me anë të këtij projektligji janë propozuar disa ndryshime në kreun e shkeljeve në fushën e akcizës dhe sanksionet, ku evidentojmë:

- Në nenin 86 “Penalitetet”, shtohet pika 3: për arsye se është hasur një vakum lidhur me përcaktimin e shkeljes së rregullave në qarkullimin e pullave fiskale, gjatë proceseve të porositjes, prodhimit, lëvizjes, dhe duke qenë se pullat e akcizës nuk janë mall akcize në vetvete;
- Janë hequr fjalët “...për tentativë për të shmangur produktin nga pagesa e akcizës”: pasi tentativa, si shkelje është e trajtuar në nen të veçantë, përkatësisht në pikën 3 të nenin 96/1, të këtij ligji;
- Pas nenit 94 shtohet neni 94/1: për të rregulluar ndëshkimin e shkeljeve në rastet e tepricave ose mangësive në pulla fiskale, të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomik në porositje, prodhim, lëvizje, dispozitë kjo, e cila ka munguar deri tani. Ndërkohë që kjo situatë është e rregullur për tepricat ose mangësitë e pullave fiskale në magazinat fiskale, përkatësisht në pikën 10 të nenit 90 të ligjit.
- Me qëllim unifikimin e terminologjisë në të gjithë ligjin që ka si synim detyrimet e akcizës, janë propozuar disa zëvendësime fjalësh, ku fjalët “detyrime fiskale” të zëvendësohen me “detyrime të akcizës”.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në harmoni me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe mbështetet në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-së (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.61/2012 ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, synon të afrojë përputhshmërinë e këtij ligji me akte të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur, me Direktivën 2011/64/BE është e pjesshme. Tabela e përputhshmërisë bashkëlidhur këtij relacioni.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 9 nene.

Neni 1 parashikon që në pikën 5, të nenit 41, “Aplikimi i pullave fiskale” të shtohen fjalët “... dhe te duhani i grirë...”.

Neni 2 parashikon që pas pikës 6, të nenit 78, “Përkufizime”, të shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Duhan me ngrohje, klasifikuar me kodin 2403 90 90 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, cilësuar si produkte duhani të riformuar dhe me substanca të tjera, që konsumohet nga një proces ngrohjeje, nëpërmjet një aparati elektronik ngrohje duhani, të klasifikuar ne kodin 8543 70 90, i cili lejon përdoruesin të thithë avujt nga duhani që gjendet në të.”.

Neni 3 parashikon që pas pikës 2, të nenit 86, “Penalitetet” të shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Penalitetet për të gjitha shkeljet e kryera në qarkullimin e pullave fiskale gjatë proceseve të porositjes, prodhimit, lëvizjes së tyre rregullohen nga ky kre”.

Nenet 4 dhe 7 parashikojnë zëvendësimin e termit “detyrimet fiskale” me “detyrime të akcizës” në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 88, “Prodhimi klandestin i produkteve të akcizës”, dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 95, “Mbajtja, transportimi ose shitja e produkteve të akcizës pa shënjes ose ngjyruet”.

Neni 5 parashikon që në shkronjën “c”, të pikës 6, të nenit 90, “Teprica ose mangësi në magazinën fiskale dhe në qarkullimin e produkteve që i nënshtrohen akcizës”, të hiqen fjalët “...për tentativë për të shmangur produktin nga pagesa e akcizës”.

Neni 6 parashikon që pas nenit 94, të shtohet neni 94/1, si vijon:

“Neni 94/1

Shkeljet në qarkullimin e pullave fiskale

Tepricat ose mangësitë në pullat fiskale, të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomik në porositje, prodhim, lëvizje, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që

duheshin paguar për produktet e akcizës të konvertuara në sasi të përkatëse, sipas parashikimeve të këtij ligji.”.

Neni 8 parashikon zëvendësimin e shtojcës nr.1, “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, me shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Në këtë shtojcë bëhet ndryshimi i nivelit të akcizës për produktet e duhanit, purot dhe cigarillos, shtohet produkti “duhan me ngrohje”, hiqen nga lista e mallrave të akcizës fishekzjarrët, llambat, pilat/bateritë dhe “rëra bituminoze, dhe vendosjen e akcizës për produktin “zhavorr bituminoz”.

Neni 9, parashikon botimin në “Fletoren zyrtare” dhe hyrjen në fuqi të ligjit më 1 janar 2019.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT DHE QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet në buxhetin e shtetit nga parashikimet e këtij projektligji vlerësohen pozitive, përafërsisht në masën +144 milionë lekë.

KËSHILLI I MINISTRAVE